



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 164

Tiranë – E premte, 22 tetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13271, datë 15.10.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 15049
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 20.10.2021	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme..... 15049
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 20.10.2021	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes..... 15050
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 606, datë 20.10.2021	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë..... 15050
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 607, datë 20.10.2021	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës 15051
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 20.10.2021	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural..... 15052
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 20.10.2021	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 15053
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 20.10.2021	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes..... 15054
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 20.10.2021	Për emërim në detyrë..... 15055
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 20.10.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore”, të ndryshuar..... 15055
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 20.10.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njëjësive individuale të banimit dhe njëjësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Durrës..... 15056

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 20.10.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1151, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....	15056
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 20.10.2021	Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre.....	15057
Urdhër i drejtorit të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” nr. 288, datë 14.10.2021	Për delegim kompetence në SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.....	15065
Rregullore e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 13.10.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 1, datë 7.3.2014, “Për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, ‘Për peshkimin’”, të ndryshuar.....	15065
Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 8.10.2021	Për shpalljen e kandidatëve fitues për anëtarë gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.....	15067
Vendim i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 11, datë 20.10.2021	Për miratimin e formularit të vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit për vitin 2021.....	15067
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 157/8, datë 18.10.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i parkimit publik, lulishte e ndriçim”, Bashkia Cërrik.....	15069
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 476/3, datë 18.10.2021	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i “Nënstacionit 400 kV, Elbasan 3”	15072

**DEKRET****Nr. 13271, datë 15.10.2021****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 8, 20 e 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Visar Naim Emerllahu
2. Adriele Jonathan Hugo Rosheger
3. Giovanni Domenico Stella Grande
4. Lumnije Zenel Krasniqi (Rafuna)
5. Faton Fatmir Daci
6. Shqipe Namon Gjergaj (Cakolli)
7. Erolind Avni Peposhi
8. Erodon Avni Peposhi
9. Almendon Avni Peposhi
10. Angelo Cataldo Alo’
11. Blendi Agim Bejdoni
12. Aiydeh Yassin Dalloul
13. Burim Sabri Hashani
14. Vesa Shkëlzen Bashota
15. Nita Shkëlzen Bashota
16. Drin Shkëlzen Bashota
17. Arian Genc Bashota
18. Lyra Genc Bashota
19. Duruntina Kristë Gjini (Selitaj)
20. Baki Islam Qerimaj
21. Safa Ali Aldaas
22. Basma Mhd-Ayman Alsarraj
23. Avdyl Halil Maroshi
24. Dafina Naim Dedolli (Behluli)
25. Marigonë Ahmet Rrotlla (Shoshi)
26. Francesco Paolo Luca Vitobello
27. Mattia Giovanni Clemente

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM**Nr. 604, datë 20.10.2021****PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Brendshme është përgjegjëse për zbatimin e politikës së punëve të brendshme në Republikën e Shqipërisë, është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në çështjet e punëve të brendshme.

3. Ministria e Brendshme ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, kryesisht, por jo vetëm, në fushat e përgjegjësisë shtetërore të:

- a) rendit dhe sigurisë publike;
- b) luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikut të qenieve njerëzore;
- c) menaxhimit të integruar të kufirit dhe migracionit;
- ç) azilit dhe shtetësisë;
- d) antiterrorit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
- dh) administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi;
- e) veprimtarisë së prefektit të qarkut;
- ë) bashkërendimit me njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë;
- f) shërbimeve të gjendjes civile;
- g) hartimit të politikave, koordinimit dhe mbikëqyrjes së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri;
- gj) veprimtarisë së organit qendror blerës, me autorizim të Këshillit të Ministrave;

h) parandalimit, mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe kontrollit/inspektimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave



dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.

4. Vendimi nr. 502, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 605, datë 20.10.2021

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë së Mbrojtjes është hartimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme shtetërore të sigurisë së pavarësisë dhe të mbrojtjes së tërësisë territoriale të vendit, si dhe rendit të tij kushtetues, në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Strategjinë Ushtarake, Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe kompetencat për realizimin e saj parashikohen në ligjin nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Ministria e Mbrojtjes planifikon e përballon emergjencat civile dhe vendos bazën juridike e administrative për rregullimin e marrëdhënieve që lindin, ekzistojnë dhe shuhen gjatë administrimit,

mirëmbajtjes e kontrollit të pronësisë në rezervat materiale të shtetit.

5. Vendimi nr. 501, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 606, datë 20.10.2021

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Drejtësisë është organi përgjegjës për zbatimin e politikës së drejtësisë, në kërkim të respektimit të Kushtetutës, të ligjeve, realizimit dhe mbrojtjes së dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe kontribuon në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik e të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

3. Fushat e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe kompetencat për realizimin e tyre parashikohen në nenet 5 dhe 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar.

4. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për



parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj ose akte të Këshillit të Ministrave.

5. Vendimi nr. 506, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 607, datë 20.10.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË KULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Kulturës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Hartimin, programimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare të kulturës, trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritetit kulturor në familjen evropiane e botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

b) Hartimin dhe bashkërendimin e punës për politikën në fushën e artit e të kulturës, nëpërmjet edukimit të popullsisë, rrijtjesimit të vlerave e të trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të

mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijmësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal;

c) Hartimin e politikave mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme ligjore e mbështetëse për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve;

ç) Hartimin e politikave për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse;

d) Udhëheqjen, programimin dhe mbështetjen e veprimtarive kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike e letrare brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimit të vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara edhe ato bashkëkohore, dhe krijimin e një hapësire dialogu mbarëshqiptar e të diversitetit kulturor;

dh) Realizimin e regjistrimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet, personat fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore;

e) Zhvillimin e politikave për nxitjen e investimeve për pasuritë kulturore, sigurimin e mbështetjes financiare nëpërmjet Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore, qendrat art & zeje në shkolla, si dhe formimit në vazhdim për të licencuarit në pasuritë kulturore materiale.

3. Vendimi nr. 507, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 608, datë 20.10.2021****PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHETËTËRORE TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka si mision hartimin e zbatimit e politikave në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufrutorë.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) Harton e zbaton politikat shtetërore për çështjet e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufrutorë;

b) Harton e propozon miratimin e projektakteve për përafrimin e legjislacionit në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, veterinarisë, peshkimit dhe akuakulturës me normat e kërkesat e Bashkimit Evropian, miraton projektaktet që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë, si dhe vlerëson nevojat e planifikon fondet e nevojshme për zbatimin e tyre;

c) Harton e zbaton politikat orientuese, mbështetëse dhe nxitëse për prodhimin bujqësor e blegtoral, si dhe kujdeset për zhvillimin e koordinuar të bujqësisë;

ç) Ndjek përgatitjen e strukturave të saj për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të Komisionit Evropian për zhvillimin rural, harton e zbaton programin IPARD, në përputhje me aktet rregullatore të Bashkimit Evropian;

d) Zbaton mbështetjen financiare të qeverisë për fermerët, agrobizneset dhe peshkatarët, bazuar në politikat e programit të qeverisë për mbështetjen e tyre;

dh) Harton e zbaton politika për miradministrimin e tokës bujqësore, si dhe mbrojtjen e tokës nga proceset natyrore dhe faktorët e tjerë që mund ta dëmtojnë atë;

e) Harton e zbaton politika për menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes dhe të kullimit, si dhe merr masa të përshtatshme për mbrojtjen e tokave nga përmbytjet;

ë) Harton e zbaton politikat për ushqimin, sigurinë ushqimore, cilësinë e produkteve ushqimore, duke përfshirë gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë;

f) Harton e zbaton politikat në fushën e veterinarisë, për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, epidemiologjinë, identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe lëvizjet e tyre, me qëllim garantimin e shëndetit publik veterinar;

g) Harton e zbaton politikat në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe luftimit të dëmtuesve;

gj) Bashkëpunon me organet e vetëqeverisjes vendore për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe të kullotave;

h) Harton e zbaton politikat shtetërore për peshkimin dhe akuakulturën në Shqipëri dhe menaxhimin e burimeve peshkore;

i) Harton e zbaton politikat e zhvillimit rural, agroturizmit, standardet e cilësisë, produktet organike, si dhe cilësinë e jetës në fshat dhe të zhvillimit rural;

j) Kujdeset për ngritjen e funksionimin e shërbimit këshillimor publik në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, si dhe nxit shërbimet digjitale dhe inovacionin në bujqësi, duke bashkëpunuar me universitetet bujqësore;

k) Harton e zbaton politikat për marketingun agrar dhe agropërpunues. Përgatit strategji dhe projekte, duke bashkëpunuar edhe me organizma ndërkombëtarë për analizimin e zhvillimit e shkëmbimeve tregtare dhe sidomos për rritjen e eksportit të produkteve shqiptare;

l) Harton regjistrin e fermerëve.

4. Vendimi nr. 512, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, i ndryshuar, shfuqizohet.



5. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 609, datë 20.10.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHETËTËRORE TË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin e zbatimit e politikave dhe të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor e për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55, të Kushtetutës. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me legjislacionin përkatës, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Zhvillimin e politikave e të strategjive shtetërore në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor;

b) Zhvillimin e monitorimin e politikave të legjislacionit, të programeve dhe të veprimtarive, që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor e me treguesit shëndetësorë të popullatës;

c) Zhvillimin e strategjive dhe të politikave që synojnë përmirësimin gradual të performancës së të gjithë ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, nëpërmjet sistemit të akreditimit;

ç) Zhvillimin e politikave dhe të programeve kombëtare, që synojnë mbrojtjen e promovimin e shëndetit, si dhe parandalimin, diagnostikimin e trajtimin e sëmundjeve në popullatë;

d) Hartimin e përditësimin e të gjitha protokolleve të mjekimit sipas praktikave bashkëkohore;

dh) Zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin e përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, të familjeve dhe të komuniteteve në nevojë;

e) Zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore, të abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, etnisë dhe minoritetit;

ë) Zhvillimin e politikave dhe të modeleve për ndihmën e shërbimet shoqërore alternative për individët e grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike;

f) Nxitjen e zhvillimin e dialogut social, në kuadrin e partneritetit, me qëllim harmonizimin e interesave të palëve për minimizimin e konflikteve sociale;

g) Marrjen e masave e ndjekjen e çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.

4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për hartimin e strategjive, sektoriale dhe ndërsektoriale, që përfshijnë fushat e përgjegjësisë shtetërore të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Vendimi nr. 508, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 610, datë 20.10.2021****PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHETETËRORE TË
MINISTRI TË SHETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të promovojë bashkëpunimin ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen.

3. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Shqyrton, ndjek dhe trajton ankesat administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre;

b) Promovon transparencën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asiston sipërmarrjen në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore të lidhura me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, kundrejt institucioneve publike;

c) Ndërmjetëson komunikimin e sipërmarrjes me institucionet publike për zbatimin e kontratave, si dhe zhvillon mekanizma të zgjidhjes paraprake të mosmarrëveshjeve midis tyre;

ç) Inkurajon zhvillimin e partneritetit dhe të komunikimit ndërmjet institucioneve publike dhe sipërmarrjeve, si dhe organizatave përfaqësuese të tyre;

d) Identifikon pengesat e biznesit në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe formulon strategjitë e ndërhyrjes për reduktimin e barrierave administrative.

dh) Angazhohet në monitorimin e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen;

e) Propozon mekanizma institucionalë/ndërinstitucionalë në funksion të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen.

4. Me qëllim realizimin e veprimtarisë si më sipër, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes:

a) përpunon dhe propozon përmirësimet e nevojshme funksionale, për platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre, si dhe për regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes të cilit monitoron procesin ndërinstitucional dhe i raporton Kryeministrit çdo fillim muaji;

b) krijon rregulloren e procedurës së brendshme, e cila detajon procedurën e:

i. regjistrimit dhe të pranimit të ankesave, sipas kritereve të përcaktuara në rregullore;

ii. komunikimit dhe të investigimit të çështjeve të pranura me institucionet e lidhura publike;

iii. mbledhjes së evidencave dhe të informacionit të nevojshëm nga institucione të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike dhe/ose personave të tretë;

iv. komunikimit ndërmjet institucioneve publike dhe të sipërmarrjes që ka kryer ankimin;

v. raportimit dhe publikimit të statusit të ankesave të trajtuara.

5. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes trajton të gjitha çështjet, përveç çështjeve, për të cilat është hapur një proces gjyqësor dhe/ose ka një vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Vendimi nr. 511, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 611, datë 20.10.2021****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Enkelejda Muçaj emërohet zëvendës-ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 612, datë 20.10.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE
ARSIMORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, shifra “... 9 531 941 818 (nëntë miliardë e pesëqind e tridhjetë e një milionë e nëntëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “...10 459 484 196 (dhjetë miliardë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ...”.

2. Në nënndarjen “i”, të pikës 1, shifra “... 5 184 188 593 (pesë miliardë e njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë ...” zëvendësohet me “... 6 111 730 971 (gjashtë miliardë e njëqind e njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) lekë ...”.

3. Në pikën 2.1 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shifra “... 3 928 793 173 (tre miliardë e nëntëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë ...” zëvendësohet me “... 4 539 106 464 (katër miliardë e pesëqind e tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë ...”.

b) Në fund të pikës 2.1 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Efekti financiar shtesë për vitin 2021 do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.”.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 613, datë 20.10.2021****PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIFORCIMIT TË NJËSIVE
INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE
NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT), NË BASHKINË DURRES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 561 411 457 (pesëqind e gjashtëdhjetë e një milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e rihforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në Bashkinë Durrës.

2. Fondi i rindërtimit për financimin e rihforcimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, për vitin 2021, të jetë në masën 112 282 291 (njëqind e dymbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë.

3. Efekti financiar, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe t’i kalojë Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e

Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 614, datë 20.10.2021****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 1151, DATË
24.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
NUMRIT TË PUNONJËSVE ME
KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR
VITIN 2021 NË NJËSITË E QEVERISJES
QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1151, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 2605 veta.

2. Në lidhjen nr. 1, përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhet shtesa e mëposhtme:

a) Në ndarjen “Gr. 13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, shtohet nënndarja përkatëse, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Fjalja e fundit, e pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përfshijmë bëjnë specialistët e aparatit të Kryeministrit, të cilët paguhën në kategorinë e pagës së nivelit III-b dhe specialistët e Shërbimit Social Shtetëror, të cilët paguhën me IV-a”.

II. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të depozitojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të



punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr. 1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
13	Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale				
	Drejtoria e Përgjithshme e SH.S.SH	15	Specialiste	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	Drejtoria e Përgjithshme e SH.S.SH	1	Kryekujdestare	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	Drejtoria e Përgjithshme e SH.S.SH	12	Kujdestare	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	Drejtoria e Përgjithshme e SH.S.SH	2	Kuzhinierë	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	Drejtoria e Përgjithshme e SH.S.SH	3	Sanitare	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	33			

VENDIM

Nr. 617, datë 20.10.2021

PËR TREGUESIT STATISTIKORË TË VLERËSIMIT E TË MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË NDIHMËS EKONOMIKE, TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE, SI EDHE PERIODICITETIN E MBLEDHJES SË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimi dhe monitorimi i programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore realizohen në nivel vendor e kombëtar e kanë për qëllim:

a) monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të objektivave, të masave dhe të veprimeve, në zbatim të legjislacionit, strategjive dhe programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve të përkujdesjes

shoqërore, rezidenciale apo komunitare, të ofruara nga persona juridikë, publikë e privatë;

b) vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve, në zbatim të politikave dhe të programeve të mbrojtjes shoqërore;

c) vlerësimin e ndikimit të politikave në uljen e varfërisë, shmangien e përjashtimit shoqëror dhe garantimin e mundësive të barabarta;

ç) hartimin e rekomandimeve dhe të politikave për mbështetjen e grupeve në nevojë.

2. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe struktura në varësi të saj grumbullojnë dhe përpunojnë të dhëna statistikore, si dhe hartojnë raporte për:

a) përcaktimin e nevojave për shërbime të përkujdesjes shoqërore për grupet në nevojë të popullsisë;

b) përcaktimin e nevojave për mbështetje me pagesa dhe/ose shërbime të familjeve e individëve në nevojë;

c) përcaktimin e numrit dhe të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, që ofrohen nga personat juridikë, publikë dhe privatë, organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në nivel qarku e bashkie;

ç) vlerësimin e nevojave për shërbime të reja të përkujdesjes shoqërore, në përputhje me kërkesat dhe burimet për ngritjen e tyre.

3. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, çdo 2 (dy) muaj, brenda datës 15 të



muajit pasardhës, dërgojnë të dhëna statistikore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror për numrin e familjeve/individëve, që aplikojnë për ndihmë ekonomike, për numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe për fondet e përdorura, sipas modularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Bashkitë, çdo 2 (dy) muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, dërgojnë në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të dhëna statistikore për numrin e personave me aftësi të kufizuara, që mbështeten me pagesë, si dhe për fondet e përdorura, sipas modularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për bashkitë, në të cilat zbatohet vlerësimi biopsikosocial, të dhënat statistikore dërgohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror nga drejtoritë rajonale nën juridiksionin e të cilave janë këto bashki.

5. Bashkitë dhe qarqet, çdo 2 (dy) muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, dërgojnë në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të dhëna statistikore për numrin e llojet e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, që ofrohen nga personat juridikë, publikë dhe privatë, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe për nevojat për shërbime të reja të përkujdesjes shoqërore, sipas modularit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Personat juridikë, publikë e privatë, dhe organizatat jofitimprurëse të licencuara, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, dërgojnë, çdo 2 (dy) muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, në bashkinë/njësinë administrative, ku ofrojnë shërbimet e përkujdesjes shoqërore, si dhe në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të dhëna statistikore për shërbimet e përkujdesjes shoqërore të ofruara dhe numrin e përfituesve, sipas modularit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Drejtoria rajonale e Shërbimit Social

Shtetëror vlerëson, përpunon e standardizon të dhënat e grumbulluara sipas pikave 3, 4, 5 dhe 6, të këtij vendimi, dhe ia dërgon, brenda datës 15 të muajit pasardhës, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

8. Bashkitë, personat juridikë, publikë e privatë, dhe organizatat jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore, u dërgojnë një kopje të raportit të të dhënave strukturave përgjegjëse për shërbimet e përkujdesjes shoqërore në qark.

9. Drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror lidh aktmarrëveshje me institucione të tjera për shkëmbimin e të dhënave statistikore periodike.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara, në përputhje me standardet e përcaktuara me udhëzim të ministrit, i dërgon në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale dhe në Institutin e Statistikave.

11. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale të nxjerrë udhëzim për mënyrën e paraqitjes së të dhënave statistikore për programin e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore.

12. Vendimi nr. 617, datë 7.9.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore”, shfuqizohet.

13. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



MODULAR 1 – PROGRAMI I NDIHMËS EKONOMIKE (NE)

Nr.	Grupi i synuar	Indikator i monitorueshëm	Përmbajtja	Specifikime	Periodiciteti
1.	Familjet/individët në nevojë	Numri i familjeve aplikuese dhe përfituese të skemës së NE.	Tregon numrin e familjeve/individëve në bashki që aplikojnë/përfitojnë NE për periudhën	Përfitues nga sistemi i pikëzimit; Përfitues nga fondi 6% mbi bazën e kriterëve specifike; Sipas numrit të anëtarëve; Sipas kategorisë familje/individ; Sipas kohëzgjatjes në skemë; Sipas gjinisë së kryefamiljarit.	Çdo 2 muaj
2.		Numri i familjeve me fëmijë 0–5, 6–15 vjeç dhe 16–18 vjeç.	Tregon numrin e familjeve në bashki që përfitojnë NE të cilët kanë në përbërje fëmijë të grupmoshës 0–5, 6–15 vjeç, 16–18 vjeç.	Sipas grupmoshave (parashkollë, shkollë 9-vjeçare, arsim i mesëm); Sipas gjinisë; Sipas arsimit që ndjekin.	Çdo 2 muaj
3.		Numri i familjeve të NE që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara (PAK).	Tregon numrin e familjeve në bashki që përfitojnë NE për periudhën dhe që kanë në përbërje PAK.	Sipas grupmoshave; Sipas gjinisë.	Çdo 2 muaj
4.		Numri i familjeve që hyjnë në skemën e NE.	Tregon numrin e familjeve në bashki që futen në skemën e NE.	Sipas numrit të anëtarëve.	Çdo 2 muaj
5.		Numri i familjeve që dalin nga skema e NE.	Tregon numrin e familjeve në bashki që dalin nga skema e NE.	Sipas shkakut të daljes nga skema.	Çdo 2 muaj
6.		Numri i familjeve që trajtohen nga fondet e pushtetit lokal dhe përfitime në natyrë.	Tregon numrin e familjeve në bashki, që mbi bazën e kriterëve specifike mbështeten me fondet e pushtetit vendor me ndihmë ekonomike ose forma të tjera ndihme.	Sipas numrit të anëtarëve; Sipas grupmoshës së fëmijëve apo PAK në përbërje të familjes; Sipas gjinisë së kryefamiljarit.	Çdo 2 muaj
7.		Fondi mujor i NE.	Tregon fondin mujor në lekë të shpenzuar për çdo bashki (në 000/lekë).	Fondi i përfituesve nga sistemi i pikëzimit; Fondi i përfituesve nga 6%.	Çdo 2 muaj
8.		Numri i familjeve të NE që përfitojnë kompensime.	Tregon numrin e familjeve që përfitojnë kompensime.	Sipas llojit të kompensimit.	Çdo 2 muaj



MODULAR 2 – PROGRAMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR

1.	Personat me aftësi të kufizuara (PAK)	Numri i PAK	Tregon numrin e PAK në bashki që përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar.	Sipas llojit të aftësive të kufizuara; Sipas masës së përfitimit të pagesës; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë.	Çdo 2 muaj
2.		Numri i ndihmësve personal	Tregon numrin e ndihmësve personal në bashki që përfitojnë pagesë.	Sipas llojit të aftësive të kufizuara të cilës i shërbejnë; Sipas llojit të shërbimit; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë.	Çdo 2 muaj
3.		Numri i invalidëve të punës	Tregon numrin e invalidëve të punës në bashki që përfitojnë pagesë shtesë për aftësi të kufizuara.	Sipas sëmundshmërisë dhe grupit të invaliditetit (sëmundje të përgjithshme, grupi I/II dhe sëmundje profesionale, grupi I/II); Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë.	Çdo 2 muaj
4.		Fondi mujor i PAK dhe ndihmësve personalë	Tregon fondin mujor në lekë të shpenzuar për çdo bashki (në 000/lekë).	Sipas llojit të aftësive të kufizuara.	Çdo 2 muaj
5.		Fondi mujor për invalidët e punës	Tregon totalin e fondit të shpenzuar për pagesën e invalidëve të punës në bashki (në 000/lekë).	Sipas sëmundshmërisë dhe grupit të invaliditetit (sëmundje të përgjithshme, grupi I/II dhe sëmundje profesionale, grupi I/II).	Çdo 2 muaj
6.		Numri i individëve PAK që përfitojnë kompensime	Tregon numrin e PAK në bashki që përfitojnë kompensime.	Sipas llojit të aftësive të kufizuara; Sipas llojit të kompensimit; Sipas gjinisë.	Çdo 2 muaj
7.		Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar	Tregon numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (0–18 vjeç) në bashki.	Sipas aftësive të kufizuara; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas sistemit arsimor që ndjekin.	Çdo 2 muaj



MODULAR 3 – SHËRBIMET E PËRKUJDESJES SHOQËRORE

Nr.	Grupi i synuar	Indikator i monitorueshëm	Përmbajtja	Specifikime	Periodiciteti
1.	Fëmijë në nevojë	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas llojit të qendrës/shërbimit; Sipas statusit të përfituesit; Në nivel bashkie; Në nivel qarku; Shërbim i ri/ekzistues.	Çdo 2 muaj
2.		Numri i përfituesve të vendosur në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e përfituesve përfitues të shërbimeve sociale në qendrat/shërbimet publike në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes së aftësisë/aftësive të kufizuara; Sipas statusit (social, arsimor, familjar) të përfituesve.	Çdo 2 muaj
3.		Numri i kërkesave për përfitim të shërbimeve shoqërore në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie për të përfituar shërbime të përkujdesjes shoqërore në qendrat/shërbimet publike	Sipas llojit të shërbimit që kërkohet; Sipas grupmoshës së kërkuesit; Sipas gjinisë së kërkuesit.	Çdo 2 muaj
4.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore në qark/bashki për periudhën (000/lekë).	Sipas llojit të qendrës / shërbimit Sipas statusit të përfituesve Sipas burimit të financimit	Çdo 2 muaj
5.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimeve që ofrojnë për përfitues të ndryshëm; Në nivel bashkie; Në nivel qarku; Shërbim i ri/ekzistues.	Çdo 2 muaj
6.		Numri i përfituesve përfitues të shërbimeve në qendrat/shërbimet jopublike	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime shoqërore në qark/bashki në qendrat/shërbimet jopublike.	Sipas statusit (social, arsimor, familjar) të përfituesve; Sipas grupmoshave; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes së aftësisë/aftësive të kufizuara.	Çdo 2 muaj
7.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki.	Sipas gjendjes familjare, shoqërore, shëndetësore, arsimimit; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë.	Çdo 2 muaj
8.	Gra në nevojë	Numri i qendrave/shërbimeve publike të	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve	Sipas llojit të qendrës/shërbimit;	Çdo 2 muaj



		përkujdesjes shoqërore	publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas statusit të përfituesve; Në nivel bashkie; Në nivel qarku; Shërbim i ri/ekzistues.	
9.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore në qark/bashki për periudhën (000/lekë).	Sipas llojit të qendrës/shërbimit; Sipas statusit të përfituesve.	Çdo 2 muaj
10.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki.	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë.	Çdo 2 muaj
11.		Numri i përfituesve përfitues të shërbimeve të përkujdesjes	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore (publike apo jopublike) në qark/bashki .	Sipas llojit të qendrës; Sipas llojit të shërbimit; Sipas grupmoshës; Sipas statusit familjar, shoqëror, shëndetësor etj.; Sipas gjendjes sociale; Sipas vendbanimit; Sipas nivelit arsimor; Sipas statusit të punësimit.	Çdo 2 muaj
12.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki.	Sipas gjendjes familjare shoqërore, shëndetësore, arsimimit; Sipas grupmoshës; Sipas gjendjes sociale; Sipas vendbanimit; Sipas nivelit arsimor; Sipas statusit të punësimit.	Çdo 2 muaj
13.	Të rinj në nevojë	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas llojit të qendrës/shërbimit Sipas statusit të përfituesve Në nivel Bashkie Në nivel Qarku Shërbim i ri/ekzistues	Çdo 2 muaj
14.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore në qark/bashki në (000/lekë).	Sipas llojit të qendrës/shërbimit; Sipas statutit të përfituesve.	Çdo 2 muaj
15.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e OJF-ve që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki.	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 2 muaj



16.		Numri i përfituesve përfitues të shërbimeve të përkujdesjes	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore (publike apo OJF) në qark/bashki.	Sipas llojit të qendrës/shërbimit; Sipas grupmoshës; Sipas statusit familjar, shoqëror, shëndetësor etj.; Sipas gjinisë; Sipas nivelit arsimor.	Çdo 2 muaj
17.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki.	Sipas gjendjes familjare, shoqërore, shëndetësore, arsimimit; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
18.	Të moshuar në nevojë	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas numrit të përfituesve; Në nivel bashkie; Në nivel qarku; Shërbim i ri/ekzistues.	Çdo 2 muaj
19.		Numri i përfituesve të vendosur në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e përfituesve përfitues të shërbimeve sociale në qendrat/shërbimet publike në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas statusit të përfituesve; Sipas gjendjes familjare /shëndetësore/aftësisë; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
20.		Numri i kërkesave për përfitim të shërbimeve shoqërore në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror në qendrat/shërbimet publike	Sipas statusit të kërkuarit; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes familjare/shëndetësore /aftësisë; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
21.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore në qark/bashki për periudhën (000/lekë).	Sipas numrit të përfituesve; Sipas llojit të shërbimit; Sipas burimit të financimit.	Çdo 2 muaj
22.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 2 muaj
23.		Numri i përfituesve përfitues të shërbimeve nga qendrat/shërbimet jopublike	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime shoqërore në qark/bashki nga qendrat/shërbimet jopublike	Sipas gjendjes së përfituesit Sipas grupmoshave Sipas gjinisë Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj



24.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki.	Sipas gjendjes familjare, shëndetësore; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
25.	Persona me aftësi të kufizuara	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas llojit të shërbimit; Në nivel bashkie; Në nivel qarku; Shërbim i ri/ekzistues.	Çdo 2 muaj
26.		Numri i përfituesve të vendosur në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e përfituesve përfitues të shërbimeve sociale në qendrat/shërbimet publike në nivel qarku dhe bashkie.	Sipas llojit të aftësive të kufizuara; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes familjare; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
27.		Numri i kërkesave për përfitim të shërbimeve shoqërore në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie për të përfituar shërbime të përkujdesjes shoqërore në qendrat/shërbimet publike.	Sipas statusit të kërkuarit; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë.	Çdo 2 muaj
28.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore një qark/bashki (në 000/lekë).	Sipas llojit të shërbimit; Sipas numrit të përfituesve; Sipas llojit të financimit.	Çdo 2 muaj
29.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
30.		Numri i përfituesve përfitues të shërbimeve nga qendrat/shërbimet jopublike	Tregon numrin e përfituesve që përfitojnë shërbime shoqërore në qark/bashki nga qendrat/shërbimet jopublike	Sipas llojit të aftësive të kufizuara; Sipas grupmoshave; Sipas gjinisë; Sipas gjendjes familjare; Sipas vendbanimit.	Çdo 2 muaj
31.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki .	Sipas gjendjes familjare, shëndetësore; Sipas grupmoshës; Sipas gjinisë; Sipas llojit të aftësive të kufizuara.	Çdo 2 muaj

**URDHËR****Nr. 288, datë 14.10.2021****PËR DELEGIM KOMPETENCE NË SU
“SHEFQET NDROQI”, TIRANË**

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 29, të ligjit nr. 162, datë 20.12.2020, “Për prokurimin publik”; të VKM-së nr. 285 datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

I. Delegimin e kompetencave të titullarit të SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, nëndrejtorit ekonomik, z. Skënder Gjoni, për çështjet e mëposhtme:

1. Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, në emër të personit që do të përfaqësojë SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë: kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadi, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesat për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si dhe t'i nënshkruajnë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga nëndrejtori ekonomik, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike, me fonde buxhetore dhe të ardhurat dytësore, për SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.

3. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

4. Të nënshkruajë komunikimet e SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht titullarit të institucionit.

5. Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga titullari i institucionit.

II. Këto kompetenca do të ushtrohen nga n/drejtori ekonomik menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

III. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimit të ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

IV. Ngarkohet z. Skënder Gjoni dhe të gjithë nëpunësit e SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Silvana Bala

RREGULLORE**Nr. 2, datë 13.10.2021****PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË RREGULLOREN NR. 1, DATË
7.3.2014, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.
64, DATË 31.5.2012, ‘PËR PESHKIMIN’”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 135, pika 2, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, miraton rregulloren si më poshtë:

Në rregulloren nr. 1, datë 7.3.2014, “Për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 ‘Për peshkimin’”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, pika 15, ndryshohet dhe riformulohet si më poshtë:

“15. Ndalohet çdolloj aktiviteti peshkimi në zonën e mbrojtur “Parku Kombëtar Detar Karaburun–Sazan”, sipas koordinatave të



përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 289, datë 28.4.2010, “Për shpalljen ‘Park Kombëtar’ të ekosistemit natyror detar pranë gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit.”.

Neni 2

Pas nenit 11, shtohen nenet 11/1 dhe 11/2 me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 11/1

Peshkimi çlodhës-argëtues

1. Aktiviteti i peshkimit çlodhës-argëtues kryhet në një distancë jo më të vogël se 500 m nga mjetet e peshkimit profesional.

2. Ushtrimi i aktivitetit të peshkimit çlodhës-argëtues ndalohet të kryhet gjatë sezonit turistik në orarin 8:30 me 19:30, në një distancë jo më të vogël se 200 m nga plazhet dhe 100 m nga brigjet shkëmbore.

3. Përjashtimisht, ky aktivitet kryhet në mole dhe shkëmbinj edhe gjatë sezonit turistik në oraret e ndalimit, me kallama dhe grepa dore vetëm në mungesë të pushuesve. Me ardhjen e pushuesve aktiviteti ndërpritet menjëherë.

4. Aktiviteti i peshkimit sportiv nuk zhvillohet me mjete të peshkimit profesional.

Neni 11/2

Peshkimi nënujor

1. Peshkimi nënujor bën pjesë në kategorinë e peshkimit amator. Gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit nënujor:

a. ndalohet të përdoren bombola oksigjeni gjatë zhytjes;

b. ndalohet zënia e koraleve, molusqeve (me përjashtim të cefalopodëve) dhe krustaceve;

c. ndalohet zënia e më shumë se 50 iriqë deti për peshkatari (grumbullimi me dorë, ndalohet nga muaji maj deri në muajin qershor);

ç. ndalohet kalimi në zonat e frekuentuara nga turistët me pushkën e karikuar;

d. ndalohet të ushtrohet aktiviteti në një distancë më të vogël se 500 m nga plazhet e frekuentuara nga pushuesit;

dh. ndalohet të ushtrohet aktiviteti në një distancë më të vogël se 100 m në plazhet shkëmbore;

e. ndalohet të ushtrohet aktiviteti në një distancë më të vogël se 100 m nga koshat e akuakulturës, rrjetave statike ose anijeve të ankoruara në port;

ë. ndalohet të ushtrohet aktiviteti në zonat e hyrjes dhe daljet nga porti ose në rrugët e zakonshme të tranzitimit të anijeve;

f. ndalohet të ushtrohet aktiviteti nga perëndimi në agim;

g. mund të përdoren mjete lundruese shoqëruese për zhvendosjen;

gj. peshkatari sinjalizon me bova dhe një flamur të kuq me vija diagonale të bardha, të dukshme në një largësi jo më të vogël se 300 m, dhe nëse përdoret një mjet lundrues atëherë flamuri vendoset mbi mjet;

h. peshkatari ushtron aktivitetin brenda një rrezeje prej 50 m nga mjeti lundrues ose nga bova (galexhanti);

i. peshkatari zë jo më shumë se 5 kg produkte peshkore dhe kjo sasi mund të tejkalohet nëse zihet një individ i vetëm me peshë më të madhe se 5 kg;

j. peshkatari zë peshq, molusqe cefalopod duke respektuar dimensionet minimale të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.”.

Neni 3

Në nenin 32, bëhen këto ndryshime:

1. Nën-pika “i”, e pikës 2, ndryshohet dhe riformulohet si më poshtë:

“i. Për mjetin lundrues me kuvertë:

a. dëshmi pronësie dhe dëshmi flamuri ose çdo dokument tjetër i barasvlershëm me to, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare;

b. certifikatë lundrimi nga Drejtoria e Përgjithshme Detare;

c. certifikatë regjistrimi dhe ekstrakti historik nga QKB-ja.”.

2. Shkronja “b” e nënpikës “ii”, të pikës 2 shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

**VENDIM**
Nr. 1, datë 8.10.2021**PËR SHPALLJEN E KANDIDATËVE
FITUES PËR ANËTARË GJYQËTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Në mbështetje të pikës 7, të nenit 17, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Votimit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përbërë nga anëtarët:

Engjëllushe Tahiri kryetare
Enisa Shahini anëtare
Lorena Çabej anëtare

Bazuar në rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarëve gjyqësorë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij,

VENDOSI:

1. Të shpallë emrat e kandidatëve fitues për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si vijon:

1) Klodian Kurushi shpallet fitues për Gjykatën e Lartë;

2) Ridvan Hado shpallet fitues për Gjykatën e Apelit;

3) Irena Plaku shpallet fitues për Gjykatën e Shkallës së Parë;

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve, duke nisur ky afat nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I VOTIMIT

Kryetare: Engjëllushe Tahiri

Anëtare: Enisa Hoxha, Lorena Çabej

VENDIM
Nr. 11, datë 20.10.2021**PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË
VETËDEKLARIMIT NGA KANDIDATI
PËR ANËTAR I GJYKATËS
KUSHTETUESE PËR POZICIONE
DREJTUESE TË MBAJTURA NË PARTI
POLITIKE GJATË 10 VITEVE TË
FUNDIT NGA DATA E KANDIDIMIT
PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe të germës “c” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi:

VENDOSI:

1. Miratimin e formularit të vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, për vitin 2021, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ky vendim ka efekt dhe fuqi juridike të përkohshme dhe do të zbatohet deri më 31.12.2021.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Ervin Pupe

**Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska,
Adnan Xholi, Rilinda Selimi, Elona Toro, Gjon
Fusha, Genti Xholi**



Lidhja nr. 1

FORMULAR VETËDEKLARIMI

**POZICIONET DREJTUESE TË MBAJTURA NË PARTI POLITIKE NGA KANDIDATI PËR
ANËTAR I GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË 10 VITEVE TË FUNDIT NGA DATA E
KANDIDIMIT PËR VITIN 2021**

(Plotësohet nga kandidati që konkurren për anëtar të Gjykatës Kushtetuese në zbatim të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”)

I. Të dhënat e kandidatit që konkurren për anëtar të Gjykatës Kushtetuese:**Gjeneralitet**

Emri	
Atësia	
Mbiemri	
Datëlindja	
Numri ID	

**II. A keni mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit?
(Vendosni shenjë X përbi përgjigjes)**

PO ☐ / JO ☐

(Nëse përgjigjeni PO, tregoni pozicionin drejtues që keni mbajtur, si dhe datën në të cilën keni ndërprerë ushtrimin e pozicionit drejtues):

(Shënim: Për qëllime të ligjit, “pozicion drejtues në parti”, konsiderohen strukturat hierarkike më të larta, monokratike apo kolegjiale, me natyrë vendimmarrëse dhe udhëheqëse në drejtim të hartimit, miratimit dhe zbatimit të qëllimeve dhe objektivave politike të partisë përkatëse, ku përfshihen por pa u kufizuar, rastet si vijon:

- a) kryetar / kryetar nderi i partisë;
- b) sekretar i përgjithshëm i partisë;
- c) anëtar i kryesisë së partisë apo i një strukture ekuivalente;
- d) anëtar i këshillit drejtues apo strukture ekuivalente;
- e) sekretar për një fushë të caktuar;
- f) kryetar i një dege të partisë në rreth;
- g) sekretar i një dege të partisë në rreth;
- h) çdo funksionar tjetër i cili kryen një detyrë apo mban një post që konsiderohet pozicion drejtues sipas statutit të partisë.

Unë, i/e nënshkruari/a _____, me nënshkrimin e këtij formulari konfirmoj nën përgjegjësinë time ligjore saktësinë e të dhënave të pasqyruara këtu dhe jam i vetëdijshëm se pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë formular mund të pasjellë si pasojë skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.

Datë ____/____/____

 (emër, mbiemër, nënshkrimi)

**KËRKESË****Nr. 157/8, datë 18.10.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i parkimit publik, lulishte e ndriçim”, Bashkia Cërrik.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Cërrik.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në

Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jobanimi”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1 883 925 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LISTA PARAPRAKE EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I PARKIMIT PUBLIK, LULISHTË E NDRIÇIM”, BASHKIA ÇËRRIK

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pas.	Sip. e përgj. truall (m ²)	Sip. e prekur truall (m ²)	Çmimi për truall	Vlera e truallit të prekur (lekë)	Sip. e gjurmës së objektit sipas kartelës (m ²)	Sip. e përgj. e ndërtimit të objektit sipas kartelës	Sip. e shërbimit (m ²)	Vlera e sip. së prekur, objekt shërbimi me situacion (lekë)	Vlera e përgj. truall + objekt (lekë)	Konfirmim nga ASHK Elbasan
1	Tajar Kudret Pëllumbi	1389	2/39/4	135	135	419	56,565	45	45	45	916,292	972,857	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan.
2	Sali Ismail Braho	1389	2/93	36	36	419	15,084	36	36	36	529,835	544,919	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan.
3	Hajrie Sherif Qevani	1389	2/94-nd.	0	0	0	0	22.7	22.7	22.7	337,615	337,615	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan.
	Hajrie Sherif Qevani	1389	2/221	68.1	68.1	419	28,534	0	0	0	0	28,534	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan.
4	Shtet (sip. totale 713 m ²)	1389	2/40	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan.



5	Shtet (sip. totale 39 m ²)	1389	2/184	39	39	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan.
6	Shtet (sip. totale 33 m ²)	1389	2/183	33	33	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan.
7	Shtet (sip. totale 965.7 m ²)	1389	2/202/2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan.
8	Shtet (sip. totale 126.6 m ²)	1389	2/39/2	126.6	126.6	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan.
VLERA TOTALE PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT												1,883,925	

**KËRKESË****Nr. 476/3, datë 18.10.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i “Nënstacionit 400 kV Elbasan 3”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak, të llogaritur si:

1. Për pasuritë e llojit “arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 8,689,169 (tetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni**



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I “NËNSTACIONIT 400 kV ELBASAN 3”

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë arë

Nr.	TË DHËNAT E PRONËS										
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e pronës m ²	Sip. e pronës që shpronësohet m ²	Çmimi i shpronësimit në lek/m ²	Vlera e shpronësimit, lek	Shënime
Bashkia Elbasan											
Fshati Kryezjarrth											
1	Feim Avdul Zeneli dhe Alie Begtash Zeneli			2296	44/1/3	arë	2,500	2,125	222	471,750	Pasuria 44/1, ndarë.
	Mirela	Preni	Merdani	2296	44/1/4	arë	2,000	1,700	222	377,400	
2	Nosi	Vasil	Biba	2296	44/2	arë	4,000	3,187	222	707,514	Pasuria 44/3 është ndarë në 2 pasuri.
3	Englantina	Josif	Ranxha	2296	44/3/1	arë	1,625	1,294.6	222	287,401	
	Englantina	Josif	Ranxha	2296	44/3/2	arë	1,625	1,354.2	222	300,632	
4	Ndriçim	Mathe	Tollumi	2296	44/4	arë	3,792	3,143.7	222	697,901	
5	Bashkëpronësi Familja Zela			2296	44/5	arë	2,700	1,882.4	222	417,893	Pasuria 45/2 është ndarë në 2 pasuri.
6	Dhimiter	Vasil	Zela	2296	44/6	arë	2,700	62	222	13,764	
7	Thoma	Ilia	Bica	2296	45/2/1	arë	2,900	2,546	222	565,212	
8	Jorgji	Tasi	Bica	2296	45/3	arë	2,750	2,621.4	222	581,951	
9	Foti		Ranxha	2296	45/4	arë	4,125	4,034.6	222	895,681	
10	Shtet			2296	45/5	arë	5,625	5,441.3	-	-	
11	Shtet			2296	45/6	arë	1,875	86.9		-	
12	Bashkëpronësi Familja Roci			2296	45/7	arë	3,539	1,470	222	326,340	
13	Kostandin	Simon	Drizari	2296	45/8	arë	5,000	2,360	222	523,920	
14	Petrit	Grigor	Drizari	2296	45/9	arë	2,500	1,317.5	222	292,485	
15	Ligor	Simon	Drizari	2296	45/10	arë	810	459.5	222	102,009	
16	Agim	Jakov	Tollumi	2296	45/11	arë	3,310	1,965.5	222	436,341	
17	Nikolla	Vasil	Biba	2296	45/12	arë	1,570	983	222	218,226	
18	Aleks	Vasil	Biba	2296	45/13	arë	5,500	3,540	222	785,880	
19	Bashkëpronësi Familja Nikolla			2296	45/14	arë	2,375	1,890	222	419,580	
20	Gezim Naum Shati dhe Bukurie Peter Shati			2296	45/15	arë	1,625	1,204	222	267,288	
21	Shtet			2296	45/16	arë				-	
Sipërfaqe totale shpronësimi m ²								44,668.60			
Vlera totale e shpronësimit në lek për sipërfaqet e pronësishë										8,689,168.80	

Shënime:

1. Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë